



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/51
Datë: 24.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25 paragrafi 1.4. dhe paragrafi 2. të Ligjit Nr. 05/L-081 për Energjinë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

Për Masat e emergjencës në furnizimin e energjisë

1. Qeveria shpallë masat emergjente për kufizim të furnizimit me energji, të vlefshme në një kohëzgjatje maksimale deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.
2. Masat emergjente në furnizim me energji përfshijnë:
 - 2.1. Vendosijen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët, dhe/ose;
 - 2.2. Vendosijen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë.
3. Themelohet Komiteti Teknik Emergjent në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë me qëllim të identifikimit dhe paraqitjes së rekomandimeve Ministres së Ekonomisë, në përbërje:
 - 3.1. Një (1) përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Kryesues;
 - 3.2. Një (1) përfaqësues nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRË), anëtar;
 - 3.3. Një (1) përfaqësues nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), anëtar;
 - 3.4. Një (1) përfaqësues nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), anëtar;
 - 3.5. Një (1) përfaqësues nga Operatori i Sistemit të Distribucionit (KEDS), anëtar;
 - 3.6. Një (1) përfaqësues nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (KESCO), anëtar;
 - 3.7. Një (1) përfaqësues nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, anëtar;
 - 3.8. Një (1) përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 3.9. Një (1) përfaqësues nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, anëtar; dhe
 - 3.10. Një (1) përfaqësues nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, anëtar.
4. Ministria e Ekonomisë gëzon të drejtën e ftesës në takime të Komitetit Teknik Emergjent edhe të zyrtarëve nga institucione të tjera relevante apo ndërmarrje të energjisë, varësisht nga nevoja.
5. Komiteti Teknik Emergjent, në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2017 mbi Rregullat për Masat Kufizuese të Furnizimit me Energji në Situata Emergjente, identifikon dhe rekomandon zbatimin e masave për t'i trajtuar efektet negative të rrethanave të krijuara, duke përfshirë, por pa u kufizuar në masat si në vijim:

- 5.1. Të vendosë kufizime mbi aktivitetet komerciale që kanë të bëjnë me burime të caktuara të energjisë;
 - 5.2. Të vendosë kushte të veçanta komerciale;
 - 5.3. Të kufizojë tregtimin e energjisë ose të vendosë kushte të veçanta për tregtimin e energjisë;
 - 5.4. Të detyrojë prodhimin e energjisë që do të ndodhë në objekte të saktësuara të prodhimit; dhe
 - 5.5. Të vendosë detyrime për furnizim me energji për konsumatorë të caktuar, vetëm në pajtim me kriteret e parapërcaktuara dhe objektive të sajura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe të miratuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.
6. Ministria për Ekonomi, pas rekomandimeve nga Komiteti Teknik Emergjent, sipas nenit 5 të këtij Vendimi, merr Vendim dhe publikon masat kufizuese të cilat janë të obligueshme për të gjitha institucionet kompetente dhe ndërmarrjet e energjisë të cilave u adresohet.
 7. Kategoritë e konsumatorëve të mbrojtur trajtohen sipas nenit 8. të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2017 mbi Rregullat për Masat Kufizuese të Furnizimit me Energji në Situata Emergjente.
 8. Obligohen Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, institucionet dhe entitet tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij Vendimi.

A r s y e t i m

Sistemi Elektro-Energjetik i Kosovës aktualisht është duke u përballur me vështirësi të theksuara si reflektim i rritjes së theksuar të konsumit të energjisë elektrike në vend, pamjaftueshmërisë së gjenerimit të brendshëm për të mbuluar konsumin, dhe krizës globale energjetike që ka rezultuar me rritjen enorme të çmimit të energjisë elektrike në bursat ndërkombëtare.

Vështirësitë në furnizim me energji elektrike janë paraqitur sidomos gjatë muajit dhjetor 2021, për shkak të avarive të shkaktuara në gjeneratorët e termocentralit "Kosova A" dhe "Kosova B" dhe njëkohësisht rritje të theksuar të konsumit të energjisë elektrike. Duke pasur parasysh se rreth 85% e konsumatorëve në Kosovë janë konsumatorë shtëpiak, kërkesa për energji elektrike është rritur dukshëm si rrjedhojë e uljes së temperaturave.

Si pasojë e konsumit të shtuar mund të paraqiten pasoja të shumta, siç janë:

- Amortizim të aseteve: Ngarkesat në sistemin energjetik shkaktojnë amortizim të konsiderueshëm të aseteve si dhe mbingarkesa në pajisjet elektrike, dhe në të njëjtën kohë kërkojnë import të shtuar në kohë të pikut.
- Imbalance në sistemin interkonektiv: Si rrjedhojë e mosbalancës së theksuar në mes të konsumit të energjisë elektrike në vend dhe energjisë së siguruar nga operatorët përgjegjës në treg, aktualisht janë duke u shkaktuar imbalance të mëdha ndaj sistemit interkonektiv, ku aktualisht rreth 40% e konsumit në Kosovë po tërhiqet nga sistemi interkonektiv i Evropës Kontinentale në formë të devijimeve.
- Vërejtje nga ENTSO-E: Qendra Koordinuese për Evropën Kontinentale në kuadër të ENTSO-E (SwissGrid) si dhe Grupi Regjional i Evropës Kontinentale (RGCE), trup i ENTSO-E, kanë kërkuar në mënyrë strikte ndërprerjen e menjëhershme të devijimeve ndaj rritit interkonektiv evropian. Derisa monitoruesi i Bllokut AK në vazhdimësi i ka tërhequr vërejtjen zonës rregulluese të Kosovës për situatën.

Për të ruajtur integritetin e sistemit dhe kontribuar në balancimin e Sistemit Elektroenergetik të Kosovës dhe atij Evropian, Qeveria autorizohet përmes Ligjit (Nr. 05/L-81) për Energjinë, neni 25, që të shpallë masat e emergjencës në furnizim me energji. Një shpallje e tillë mundëson marrjen e masave që kanë të bëjnë me: (i) vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët, dhe/ose (ii) vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë, përkatësisht obligimin e Korporatës Energjetike të Kosovës të disburzujë subvencionet e Qeverisë së Kosovës për qëllim të importit të energjisë elektrike për nevojat e konsumatorëve të rregulluar.

Aprovimi i një Vendimi të tillë, sipas nenit 25.2 i mundëson Qeverisë të fillojë së zbatuari masat menjëherë që në datën e aprovimit të Vendimit nga Qeveria, megjithatë i njëjti vendim duhet të shqyrtohet për miratim edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kuvendi, brenda 7 (shtatë) ditëve nga pranimi i vendimit të Qeverisë ka të drejtën edhe të refuzojë miratimin e Vendimit në fjalë, çka e detyron Qeverinë të ndërpresë masat e aprovuara dhe të mos vazhdojë me gjendjen e emergjencës.

Vendimi i propozuar parasheh që këto masa të vendosen për një periudhë kohore deri në 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi. Megjithatë Kuvendi i Kosovës mund të vazhdojë këtë afat për periudha të njëpasnjëshme prej 30 (tridhjetë) ditësh me shumicë të votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm në seancë. Kuvendi ka të drejtë të vazhdojë afatin për një periudhë maksimale deri në 180 (njëqindetëdhjetë) ditë shtesë.

Propozim-vendimi parasheh themelimin e Komitetit Teknik Emergjent, i cili udhëhiqet nga Ministria e Ekonomisë e që në përbërjen e saj ka akterët kryesorë të sektorit dhe më gjerë. Përveç anëtarëve të Komitetit Teknik Emergjent të paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr. 04/ 2017 mbi Rregullat për Masat Kufizuese të Furnizimit me Energji në Situata Emergjente, propozim-vendimi i jep të drejtë Ministres së Ekonomisë që, varësisht nga nevoja, të ftojë edhe institucione tjera relevante apo ndërmarrje të energjisë të jenë pjesë e Komitetit Teknik Emergjent.

Komiteti Teknik Emergjent i identifikon dhe i rekomandon masat emergjente Ministres së Ekonomisë, masa këto të cilat shpallen me Vendim nga Ministria për Ekonomi në varësi të nevojës dhe situatës me furnizim me energji elektrike.


Masat që do të rekomandohen janë të përkohshme, e të cilat kanë për qëllim zbutjen e krizës së furnizimit me energji për kohën sa zgjatë kjo gjendje emergjente për furnizim me energji.

Masat e ndërmarra publikohen nga Ministria, dhe për të njëjtat njoftohet Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

9. Vendimi hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet menjëherë.

10. Ky Vendim brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga aprovimi i tij i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë